



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT  
(Para Procesit te Ankimimit)

*Maliq më 02.04.2022*

Për: **OPERATORIN EKONOMIK “INFINIT” shpk**

NIPT-i: J74304623M

Adresa : Korçë, Hudënisht, Fshati Mëmëlisht, poligoni parafabrikat Guri i Kuq, ambjent me nr pasurie 731/45, zona kadastrale 2648

Procedura e prokurimit: : **Procedurë e Hapur e Thjeshtuar/Punë/Sistem elektronik**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-21108-03-03-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Rehabilitimi i ujitjes me SEP Pojan, Maliq Faza II” Afati i kontratës: 2 muaj*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.29 datë 07.03.2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Operatori Ekonomik “INFINIT” shpk**

-Adresa: Korçë, Hudënisht, Fshati Mëmëlisht, poligoni parafabrikat Guri i Kuq, ambjent me nr pasurie 731/45, zona kadastrale 2648

-NIPT-I : J74304623M

-Vlera e ofertës është: 6,916,930 (gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

**2. Operatori Ekonomik “NIKA” shpk**

-Adresa: Shkodër, Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skënderbeu, godina 8-katëshe, Kati I-rë, Zona kadastrale 8593, Nr pasurie 5/587

-NIPT-I : J76705047U

-Vlera e ofertës është: 7,035,100 (shtatë milion e tridhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë pa tvsh

**3. Operatori Ekonomik “VËLLEZRIT KUKA” shpk**

-Adresa: Fier, Fier, Roskovec

-NIPT-I : J63423440Q

-Vlera e ofertës është: 7,329,347 (shtatë milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë e treqind e dyzetë e shtatë) lekë pa tvsh

**4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “VILDEV-CO” shpk dhe “ALB-KORÇA 2002” shpk  
ALB-KORÇA 2002**

-Adresa: Korçë, Pojan Zëmlak, Lagjia Qendër, Rruga Nacionale km 1, Zona kad. 3903

-NIPTI: K34004003T VILDEV-CO

-Adresa: Korçë, Lagjia 17, Rruga Riza Mançe, Nr.21

-NIPTI:K83926001F

-Vlera e ofertës është: 8,355,350 (tetë milion e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë)

#### **5. Operatori Ekonomik “SARK” shpk**

-Adresa: Fier, FIER, Lagjia “8 Shkurti” Rruga Skenderbej, Rajoni nr.3, përballë supermarket Lalaj

-NIPT-I : K52531415H

-Vlera e ofertës është: 8,519,050 (tetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

#### **6. Operatori Ekonomik “ASI 2A-CO” shpk**

-Adresa: Fier, Fier, FIER, Rruga Skënderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr.18, hyrja nr.6

-NIPT-I : K53002402C

-Vlera e ofertës së ofruar është 8,597,050 (tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

#### **7. Operatori Ekonomik “LTE CONSRITION” shpk**

-Adresa: Tiranë, Kashar, Rruga 3 Dëshmorët, godinë banimi dhe shërbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate me 2 kat parkimi nëntokë në pronë të shoqërisë Lloxxhall

-NIPT-I : L78006801F

-Vlera e ofertës është: 8,662,130 (tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

#### **U skualifikuan:**

##### **1- Operatori Ekonomik “VËLLEZRIT KUKA” shpk me ofertë:**

**7,329,347** (shtatë milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë e treqind e dyzetë e shtatë) lekë pa tvsh

Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: *“Rehabilitimi i ujitjes me SEP Pojan, Maliq”*

- Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Punë të ngjashme per nje objekt te vetëm në nje vlerë jo me te madhe se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit te jete jo me e vogel se fondi limit i kontrates qe prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

\* Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b

duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vertetim për kyerjen me sukses të kontrates

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin vëren se tek puna e ngjashme e paraqitur mungon Vertetimi për kyerjen me sukses të kontrates.

Për këtë qëllim të gjithë anëtarët e KVO i japin JO në sistemin elektronik dokumentave që plotësonin kriteret e mësipërme **duke e s'kualifikuar atë**.

## **2- Operatori Ekonomik “SARK” shpk me ofertë: 8,519,050 (tetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa tvsh**

- Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt: *“Rehabilitimi i ujitjes me SEP Pojan, Maliq Faza II”*

Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2018, 2019, 2020 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Mungon Raporti Auditit për Pasqyrat Financiare.

Për këtë qëllim të gjithë anëtarët e KVO i japin JO në sistemin elektronik dokumentave që plotësonin kriteret e mësipërme **duke e s'kualifikuar atë**.

## **3- Operatori Ekonomik “LTE KONSTRUKSION” shpk me ofertë: 8,662,130 (tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh**

• *Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:  
Minimalisht 14(katermbëdhjete) punonjës të kualifikuar si më poshtë:*

- *Manovrator (1)*

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

*Kur mjeti eskavator është në pronësi*

*1.kontrata e punës (e vlefshme)*

*2.Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor*

*Kur mjeti eskavator është me qera*

*Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin( i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor ) deri në perfundimin e afateve të kontratës.*

- *Muratori (10)*

- *Hekurpunues (3)*

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

*1. kontrata e punës e vlefshme;*

*2. Çertifikate për sigurinë teknike të punonjësve (e vlefshme);*

*Ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin vëren se mungojnë 9(nëntë) punonjës muratorë dhe 1(një) punonjës hekurpunues.*

*- Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt:  
“Rehabilitimi i ujitjes me SEP Pojan, Maliq Faza II”*

Për këtë qëllim të gjithë anëtarët e KVO i japin JO në sistemin elektronik dokumentave që plotësonin kriteret e mësipërme duke e **s’kualifikuar atë**.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“INFINI” shpk** shpk me NIPT J74304623M dhe adresë: Korçë, Hudënisht, Fshati Mëmëlisht, poligoni parafabrikat Guri i Kuq, ambjent me nr pasurie 731/45, zona kadastrale 2648, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **6,916,930** (gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

**Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.**

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim TOPÇIU**